



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 26.05.2026

**MBLEDHJA Nr. 24,
Datë 28.05.2026, ora 13:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 28.05.2026, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 24 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.08.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 MW”, i ndryshuar.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 06.11.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

9. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.
10. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 02.04.2026, “Mbi licencimin e shoqërisë “DION ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW”.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.
12. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 202, datë 01.09.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 12 MW”.
13. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW”, i ndryshuar.
14. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW”, i ndryshuar.
15. Mbi miratimin e “Vlerësimit të ERE-s për gatishmërinë e tregut të ditës në avancë në Shqipëri”.
16. Mbi miratimin e disa ndryshimeve në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
17. Mbi miratimin e “Strategjisë së ERE-s për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorit të energjisë, periudha: 2026 – 2028”.
18. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI